



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt (K.F), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpenzimet e prezantuara në PFV në vlerë totale 7,970,067€ nuk janë klasifikuar në kategoritë e duhura ekonomike, që janë raportuar në kategori të gabuara buxhetore, duke ndikuar në mbivlerësimin/ nënvlerësimin e kategorive ekonomike adekuate.
- B2 Vlera e detyrimeve kontigjente të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishte nën vlerësuar për 140,738€.
- B3 Prezantim jo i saktë i detyrimeve të papaguara në PVF në vlerë prej 127,235€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Ferizajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna kishte lidhur gjashtë kontrata me vlerë mbi 500,000 € për të cilat nuk ishte bërë njoftimi paraprak, siç kërkohet me rregullat e prokurimit publik.
- A2 Në tre raste është konstatuar se komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa siguruar fonde të mjaftueshme financiare, në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore.
- A3 Komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit.
- A4 Pagesa e realizuar për furnizime/punë të cilat nuk kanë qenë të përfunduara në tërësi në momentin e ekzekutimit të pagesës.
- B4 Në dy raste pagesa për investime kapitale janë paguar nga buxheti i projekteve kapitale jo përkatëse.
- B5 Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit për kohëzgjatjen e kontratës dhe mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve.
- B6 Në 89 raste, pagesat e faturave janë kryer me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh.
- A5 Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurive.
- B7 Në dy raste ishte bërë subvencionimi i OJQ-së dhe fermerëve jo në pajtim me kriteret e thirrjes publike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ferizajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Ferizajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ferizajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ferizajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësimet ose anashkalim të kontroleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rrezeqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunes së Ferizajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Kontrollet e brendshme gjatë procesit të raportimit financiar duhet të avancohen. Përmirësimet janë të nevojshme gjatë përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare dhe shpalosjeve të shënimeve shpjeguese për klasifikimi adekuat i shpenzimeve, detyrimet kontingjente dhe obligimeve të papaguara. Në aspektin e pajtueshmërisë, përmirësime janë të nevojshme në regjistrimin e pagesave në kategoritë përkatëse, njoftimet paraprake për kontratat me vlera mbi 500,000€, nënshkrimin e kontratave sipas fondeve të buxhetuara, menaxhimin e duhur të projekteve kapitale, pagesën brenda afateve të obligimeve ndaj kontraktuesve, proceset e subvencionimit dhe menaxhimit të pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me 19 rekomandime, prej tyre tetë janë rekomandime të reja, dhjetë të përsëritura dhe një pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

Gjetja

Sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 thekson se ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me numër 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat thekson se në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet i marrin brenda kufijve të ndare buxhete për komunat me këtë qarkore duke përjashtuar nga kategoria e shpenzimeve paga dhe shtesa. Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Gjithashtu, me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Rezultatet e testimeve identifikuan se pagesat në vlerë totale 7,970,067€ nuk janë klasifikuar në kategorinë e duhur ekonomike. Keq-klasifikimet kanë rezultuar te këto kategori ekonomike:

- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, e që kanë të bëjnë pagesat për kontratën kolektive të punonjësve të arsimit, janë paguar 4,548,263€ nga buxheti i kategorisë së investimeve kapitale, 2,222,935€ nga buxheti i mallrave dhe

shërbimeve, dhe 765,912€ nga buxheti i subvencioneve dhe transfereve;

- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, janë paguar 53,167€ nga buxheti i investimeve kapitale dhe 34,093€ nga subvencionet dhe transfere;
- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së subvencioneve, janë paguar 123,856€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve;
- Për shpenzime që i takojnë investimeve kapitale, janë paguar 160,100€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve dhe 61,738€ nga buxheti i subvencioneve dhe transfereve.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e Ligjit të buxheti dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Regjistrimi i shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF. Shfrytëzimi i buxhetit të investimeve kapitale për pagesën e shpenzimeve që i takojnë kategorive ekonomike tjera, vështirëson realizimin me kohë dhe si duhet të projekteve kapitale.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që me rastin e përgatitjes së buxhetit të mirren parasysh kërkesat e Ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të lëshuara nga MF, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të tyre në pasqyra financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlërim i detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja

Rregullorja MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga OB-të, neni 18, përcakton që organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në duhet raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Komuna për vitin 2025 ka nënvlerësuar detyrimet kontigjente në shumë prej 140,738€. Sipas dokumenteve burimore, vlera reale e këtij detyrimi ishte 294,252€, ndërsa në pasqyrat vjetore financiare ishte prezantuar 146,470€⁵.

Gjithashtu, në regjistër është përfshirë edhe një padi në vlerë prej 7,043€, për të cilën ekziston vendim përfundimtar nga gjykata, duke u klasifikuar si detyrim kontigjent.

Për më tepër, komuna ka raportuar gjithsej 120 raste të detyrimeve kontigjente në regjistër, prej të cilave 4⁵ raste nuk kanë të përcaktuar vlerë financiare.

Kjo ka ndodhur për shkak të gabimeve teknike dhe pakujdesisë në përditësimin e informatave në regjistrin e kontigjencave dhe prezantimin financiar, si dhe mungesës së personelit të mjaftueshëm në administrimin e lëndëve gjyqësore.

- Ndikimi** Mosazhurnimi me kohë i regjistrit të detyrimeve kontigjente, mungesa e vlerësimit për disa raste, kanë rezultuar në nënvlerësim dhe paraqitje jo të saktë të tyre në pasqyrat financiare vjetore.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e kontrolleve efektive për azhurnimin me kohë të regjistrit të detyrimeve kontigjente, në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyrat vjetore financiare të jetë i plotë dhe i saktë. Po ashtu, duhet të ndërmerren masa për vlerësimin financiar të të gjitha rasteve, në mënyrë që të sigurohet një paraqitje e drejtë dhe e qartë e gjendjes financiare të organizatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve të pa-paguara në PVF

- Gjetja** Rregullorja MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga OB-të, neni 17, përcakton që OB-të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Komuna ka nënvlerësuar obligimet e papaguara të raportuara në PVF në vlerë totale prej 127,235€.

Komuna nuk i kishte raportuar detyrimet e papaguara në vlerë prej 105,963€ për pagat e punonjësve të cilët gjatë vitit 2025 ishin përfshirë në listën e pagave, ndërsa për këta punonjës pagat nuk u janë kthyer në mënyrë retroaktive për periudhën para përfshirjes në listë.

Po ashtu, edhe 11 punonjës të tjerë, deri në fund të vitit 2025, nuk ishin regjistruar fare në listën e pagave, ndonëse ishin pranuar përmes procedurave të rregullta të rekrutimit, për të cilët komuna nuk i kishte raportuar detyrimet e papaguara në vlerë prej 21,271€.

Kjo ka ndodhur pasi drejtoria e arsimit në komunë nuk i kishte raportuar obligimet ndaj punonjësve, të cilëve nuk u ishin ekzekutuar pagat.

- Ndikimi** Kjo ka ndodhur pasi që drejtoria e arsimit në komunë nuk kishte hartuar një listë të punonjësve të cilëve nuk u janë paguar pagat si dhe mungesës së raportimit të tyre në drejtorin e financave.

- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë që drejtoria e arsimit të raportoj me kohë obligimet ndaj punonjësve dhe të mbajnë evidenca të sakta për detyrimet e papaguara, në mënyrë që ato të paraqiten saktë në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në zbatimin e kërkesave të prokurimit publik lidhur me njoftimin paraprak të kontratave

Gjetja

Sipas nenit 39 - Njoftimi Paraprak i LPP-së, përcakton “Kur një autoritet kontraktues ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të, një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej pesë qind mijë (500.000) Euro, lidhur me secilën kategori të përmendur autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin paraprak”.

Komuna kishte lidhur gjashtë (6) kontrata me vlerë mbi 500,000€, për të cilat nuk ishte bërë njoftimi paraprak, siç kërkohet me rregullat e prokurimit publik. Këto kontrata janë:

- Ritenderimi për Ndërtimin e Qendrës Multifunksionale në Ferizaj në vlerë 3,298,901€;
- Rikonstruktimi i rrugës Ferizaj-Pleshinë në vlerë 2,899,185€;
- Asfaltimi i rrugës Tërrn-Kosinë-Ferizaj në vlerë 2,442,542€;
- Asfaltimi i rrugës kryesore në Zllatar dhe trotuari deri te shkolla (Aksi 1, L=2915) në vlerë 2,334,700€;
- Asfaltimi i rrugëve Fshati i Vjetër-Komogllavë-Ferizaj në vlerë 1,549,972€;
- Asfaltimi i rrugës kryesore Zllatar dhe trotuari deri te shkolla (Aksi Rahovicë-Zllatar) në vlerë 929,296€.

Mangësitë e evidentuara kanë ardhur si pasojë e dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe mungesës së mbikëqyrjes efektive nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi

Mos aplikimi i njoftimit paraprak sipas kërkesave të ligjit përveçse përbëjnë shkelje administrative, kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në uljen e nivelit të transparencës në menaxhimin dhe planifikimin e prokurimit publik dhe kufizimin e konkurrencës për shkak të mungesës së informimit me kohë të operatorëve ekonomikë.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme efektive që në të ardhmen njoftimi paraprak të përgatitet dhe të publikohet në kohë, me qëllim rritjen e transparencës dhe sigurimin e konkurrencës së drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme**Gjetja**

Sipas nenit 37.1 të Ligjit nr 03/L-221 për ndryshim dhe plotësim të ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Sipas nenit 9.2 të Ligjit për prokurimin publik, ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal, si dhe neni 9.3. Nëse autoriteti kontraktues organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Në tre raste është konstatuar se komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa siguruar fonde të mjaftueshme financiare, në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore.

Rastet e identifikuar janë si vijon:

- Kontrata për “Rikonstruktimi i rrugës Ferizaj - Pleshinë”, në vlerë prej 2,899,185€, ku sipas memorandumit të bashkëpunimit me Ministrinë e Infrastrukturës, ministria financon 2,000,000€, ndërsa komuna 900,000€. Për këtë projekt, komuna sipas ligjit të buxhetit të vitit 2025 ka pasur mjetet të buxhetuara për vitet 2025-2026-2027 në vlerë 90,000€ duke hyrë kështu në obligime kontraktuale pa mbulim të plotë buxhetor për shumën prej 809,185€.
- Kontrata për “Asfaltimi i rrugëve Fshati i Vjetër, Komogllavë - Ferizaj”, në vlerë prej 1,549,972€, ku sipas memorandumit të bashkëpunimit me Ministrinë e Infrastrukturës, ministria financon 1,300,000€, ndërsa komuna udhëheq procedurat e prokurimit. Për këtë projekt, komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulim të plotë buxhetor për shumën prej 249,972€.
- Kontrata për “Rikonstruktimi i rrugës Bedri Asllani”, në vlerë prej 277,974€, sipas të dhënave, disponueshmëria e mjeteve ka qenë 200,000€, ndërsa komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulim të plotë buxhetor për shumën prej 77,974€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit, si dhe mungese se planifikimit të mirëfilltë buxhetore për projekte të caktuara.

Ndikimi

Hyrja në obligime financiare pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papagueshme financiare dhe shpenzimeve të përbarimit dhe anashkalim të ligjit të buxhetit si dhe vendimeve të kuvendit komunal për realizimin e projekteve kapitale, apo implikime buxhetore për vitin aktual dhe vijues.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara me ligjin për ndarjet buxhetore për të gjitha kontrata e lidhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 19.17 ndër tjerash parasheh se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Komuna ka filluar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur kontrata për projektet si në vijim, pa u hartuar paraprakisht projektet ekzekutive:

- Rikonstruktimi i rrugës Varosh-Gërlisë, në vlerë 1,849,187€;
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Jezerc, në vlerë 513,280€;
- Rikonstruktimi i rrugës Bedri Asllani, në vlerë 277,974€;
- Asfaltimi i rrugëve në Rahovicë dhe Talinoc të Muhaxherëve, në vlerë 249,150€.

Zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungesë të projektit ekzekutues ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve nga njësitë kërkuese, pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke i zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj në realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të shkaktojë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për parane e shpenzuar.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle adekuate dhe të monitorojë zbatimin e kërkesave ligjore, në mënyrë që, me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve ndërtimore, paraprakisht të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parapara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Pagesa të parregullta për projekte kapitale

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 61 - Menaxhimi i kontratës, menaxheri i kontratës është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës, verifikimin e realizimit të punimeve dhe sigurimin që pagesat bëhen vetëm për punët e kryera në përputhje me kontratën.

Nga inspektimet fizike të kryera në terren për projektet kapitale është konstatuar se, në kuadër të kontratës "Ndërtimi i shkollës së mesme në

Ferizaj” me vlerë 1,803,726€, si dhe aneks kontratës për punë shtesë në vlerë 104,340€, është realizuar një pagesë në shumën 19,999€ për punime dhe furnizime që lidhen me sallën e edukatës fizike, për të cilat punimet nuk kishin përfunduar në përputhje të plotë me kërkesat e paramasës në momentin e ekzekutimit të pagesës.

Gjithashtu, është vërejtur se menaxheri i kontratës nuk ka përgatitur raportin përfundimtar për realizimin e projektit, i cili do të duhej të përfshinte vlerësimin e përputhshmërisë së punimeve të kryera me kontratën, aneks-kontratën, paramasën dhe gjendjen faktike në terren, por vetëm ka nënshkruar situacionin për pagesën përfundimtare të punimeve të realizuara në terren.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes së dobët nga menaxheri i kontratës gjatë realizimit të projekteve kapitale.

Ndikimi Aprovimi për pagesë i punëve ende të papërfunduara ndikon në dëmtimin e buxhetit dhe mos realizimin e kontratave siç është planifikuar.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të sigurojë që menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione për punë të papërfunduara, si dhe të përgatisin raporte përfundimtare lidhur me realizimin e projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Pagesa për investime kapitale nga buxheti i projekteve kapitale jo përkatëse

Gjetja Ligji Nr. 08-L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2025, neni 16, pika 11, përcakton që, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Në dy pagesa për investime kapitale në vlerë totale prej 97,331.06 €, janë shfrytëzuar fondet e projekteve të tjera të aprovuara me Ligjin e Buxhetit.

Konkretisht:

- Nga projekti “Rregullimi i shëtitorës rreth shtratit të lumit nga Ura e Dudit deri te Ura e Islamit” janë shfrytëzuar mjete për pagesën e projektit “Mirëmbajtja dhe rregullimi i rrjetit të ndriçimit publik në Ferizaj, Komogllavë, Greme, Nerodime, Talinoc, Bibaj, Dardani, Mirosalë, Gaçkë, Tërrn dhe Prelez”.
- Nga projekti “Ndërtimi i nënkalimit për vetura dhe këmbësorë afër stacionit policor” janë shfrytëzuar mjete për pagesën e projektit “Ndërtimi i trotuarit në fshatin Kosinë dhe Dremjak”.

Këto ndryshime të mjeteve nga një projekt kapital në tjetrin janë realizuar pa miratim paraprak për ridestinim nga Kuvendi Komunal, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara për menaxhimin e buxhetit.

Kjo kishte ndodhur kryesisht nga mungesa e mjeteve buxhetore për projektet përkatëse, për shkak se nga fondi i projekteve përkatëse janë realizuar pagesa nga Thesari si rezultat i vendimeve gjyqësore për kontratën kolektive dhe konteste tjera.

Ndikimi

Përdorimi i buxhetit të një projekti për pagesën e shpenzimeve të projektit tjetër redukton transparencën dhe pamundëson prezantimin e drejtë për projektet e realizuara. Gjithashtu, kjo mund të rrezikojë realizimin e atyre projekteve prej nga janë marrë mjetet, nëse gjatë vitit nuk sigurohen mjetet e mëvonshme dhe të mjaftueshme buxhetore për ato projekte.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë se pagesat për investimet kapitale bëhen nga fondi buxhetor i projektit përkatës. Në rastet e nevojshme dhe kur krijohen mundësit për ridestinim buxhetor, rialokimi i mjeteve të bëhet në pajtim me ligjin mbi ndarjet buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit për punët shtesë dhe mos përfshirja e punëve shtesë në vlerat e garancioneve të kualitetit të punimeve

Gjetja

Sipas nenit 63 të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 29, siguria e ekzekutimit (SE) kërkohet si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e SE do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. SE do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Gjithashtu, me kushtet e veçanta të kontratës (KVK) kërkohet garancioni për kualitetin e punimeve apo furnizimeve për një afat të caktuar dhe në vlerë 10% të vlerës së kontratës.

Nga auditimi i kontratave janë identifikuar mangësi në vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit dhe në garancionet bankare për kualitetin e punimeve, si në rastet në vijim:

- Kontrata "Ndërtimi i shkollës së mesme" në vlerë 1,803,726€, me aneks kontratë për punë shtesë në vlerë 104,340€, nuk kishte mbulim të plotë të sigurimit të ekzekutimit në vlerën 10% të punëve shtesë (10,434€). Madje garancioni bankar nuk ishte bërë as për ankes kontratë, ndërsa afati i garancionit ishte 12 muaj në vend të 24 muajve të kërkuar me kontratë;
- Kontrata "Rregullimi i ujësjellësit në fshatin Greme" në vlerë 349,613€, me aneks kontratë në vlerë 29,584€, nuk kishte vazhdim të sigurimit të ekzekutimit në vlerën 10% të aneksit (2,958€). Madje, garancioni bankar nuk ishte bërë as për aneks kontratën;
- Kontrata "Ndërtimi i trotuarit Dermjak-Kosine" në vlerë 188,709€, me aneks kontratë në vlerë 18,840€, nuk kishte vazhdim të sigurimit të ekzekutimit në vlerën 10% të aneksit (1,884€). Madje, garancioni bankar nuk ishte bërë as për aneks kontratën.

Kjo ka ndodhur për shkak të mbikëqyrjes së dobët në menaxhimin e projekteve kapitale nga menaxherët e kontratave, dhe mos kërkit nga kontraktuesit vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit të kontratës dhe garancionit të kualitetit të punimeve sipas kontratave.

Ndikimi

Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit të kontratës nuk garanton mbulimin

e dëmeve dhe shpenzimeve në rast të mos përmbushjes së kontratës nga ana e kontraktuesit. Gjithashtu, mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve sipas kontratës pamundëson kompensimin e dëmeve në rastet kur punët dhe furnizimet e kontraktuara nuk janë realizuar në kualitetin e duhur.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë që, në rastet kur kontratat publike përfshijnë punë shtesë, siguria e ekzekutimit të vazhdohet deri në finalizimin e plotë të kontratës, duke përfshirë edhe vlerën e aneks kontratave. Po ashtu, pagesat përmbyllëse të kontratave nuk duhet të realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar për kualitetin e punimeve, si për kontratën bazë ashtu edhe për aneks kontratat, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mos pagesa me kohë e obligimeve dhe kosto shtesë buxhetore për shkak të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Gjetja

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), neni 39.1 përcakton që ZKF i OB-së është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës.

Në 89 raste në vlerë 9,026,303€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimi. Vonesat ishin nga 14 ditë deri në 6 vite.

Gjithashtu, sipas regjistrimit të siguruar nga komuna, gjatë vitit 2025, si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, si dhe obligimeve nga kontrata kolektive për personelin arsimor, në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, janë paguar kosto shtesë në vlerë 1,683,109€.

Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të duhur të obligimeve, si dhe shpenzimit të buxhetit nga pagesat e vendimeve gjyqësore të ndërlidhura me zbatimin e kontratës kolektive.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, kanë ndikuar që komuna të jetë subjekt i padive nga kontraktuesit, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore dhe përmbarimore.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe të sigurojë se detyrimet ndaj kontraktuesve paguhen brenda afateve kohore, duke shmangur në këtë mënyrë kostot shtesë për shkak të procedurave gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurive

Gjetja Sipas Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 19, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore. Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare ndër të tjera janë: inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore; verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare; dhe krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Komuna kishte formuar komisione për inventarizimin e pasurisë sipas njësive organizative, mirëpo disa prej tyre si komisioni për shëndetësi, komisioni për pronat e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe komisionet e objekteve arsimore (shkolla të mesme, fillore dhe qerdhe) nuk kanë dorëzuar raportet përfundimtare dhe nuk kanë kryer inventarizimin sipas kërkesave të rregullores.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të e-pasurisë dhe mosrealizimit në kohë të detyrave të planifikuara, gjë që ka rezultuar në mos harmonizimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurisë.

Ndikimi Mosrealizimi i inventarizimit të plotë kanë ndikuar në mosverifikimin e gjendjes reale të pasurive dhe si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos pasqyrojnë saktë vlerën e pasurisë së komunës.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë realizimin e inventarizimit për të gjitha njësitë dhe harmonizimin e tij me regjistrat e pasurive para përgatitjes së PFV-ve, si dhe reflektimin e rezultateve në regjistra dhe në pasqyrat financiare, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B7 - Mangësi në proceset e subvencionimit për OJQ dhe fermer**

Gjetja Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kërkon respektimin procedurave përmes plotësimit, nënshkrimit dhe dorëzimit të formularëve. Në thirrjen publike për mbështetje financiare publike të OJQ-ve në zbatimin e aktiviteteve kulturore, rinore e sportive në Komunën e Ferizajt të datës 18.02.2025 (Udhëzuesi për aplikuesit) ishte kërkuar -Formulari i Aplikacionit për projekt i plotësuar. Gjithashtu, në thirrjen publike subvencionimi i fermerëve me mekanizim bujqësor për ngritjen e kapaciteteve funksionale të tyre, të datës 03.07.2025, një ndër kriteret ishte edhe Çertifikata e Bashkësisë Familjare.

Nga auditimi i subvencioneve u identifikuan këto mangësi:

- Subvencionimi i OJQ-së "Klubi i Hendbollit" në vlerë prej 5,000€: përfituesi kishte plotësuar aplikacionin për projekt, mirëpo ai nuk ishte i plotë. Në të mungonin disa elemente kryesore të projektit, si përshkrimi i projektit, objektivat e synuara, aktivitetet kryesore që do të realizohen në kuadër të projektit, si dhe informacione të tjera

relevante.

- Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor “Pllugj 2 Rende 8 inch”: përfituesi i mekanizmit nuk kishte ofruar dëshmi, përkatësisht çertifikatën e bashkësisë familjare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe mungesës së përgjegjësisë nga komisioni i vlerësimit për zbatimin e kriterëve të vendosura në thirrjet publike.

Ndikimi

Mos respektimi i kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike me rastin e subvencionimit rrezikon transparencën gjatë procesit dhe rezulton me përzgjedhjen jo të drejtë të përfituesve përkatësisht diskriminimin e aplikantëve që kanë plotësuar kriteret e thirrjes.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit të kërkesave për subvencionim u përmbahen kriterëve të vendosura në thirrjen publike, duke përzgjedhur vetëm aplikuesit që përmbushin në tërësi kriteret e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2025 ishin 7,974,306€, ndërsa janë realizuar 8,634,241€, duke tejkaluar planin për 8.3%. Struktura e të hyrave përbëhet nga tatimi në pronë, taksat për lejet ndërtimore dhe leje mjedisore, participimet, dhe taksat tjera komunale.

Çështja B8 - Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore

Gjetja	Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtim, neni 17 pika 1.2, përcakton që “Leja Ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III”. Në katër raste të lejeve ndërtimore që i takojnë kategorisë II, kërkesat për leje ndërtimore nuk ishin shqyrtuar brenda afatit kohor ligjor. Vonesat ishin nga 11 deri 223 ditë, pas afatit të lejuar prej 45 ditëve. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos funksionimit të mjaftueshëm të kontrolleve për të shqyrtuar kërkesat e lejeve ndërtimore në afatet e përcaktuara ligjore.
Ndikimi	Shqyrtimi i kërkesave me vonesë ndikon në arkëtimin e vonuar të të hyrave nga lejet ndërtimore, si dhe në moskryerjen e shërbimeve me kohë ndaj aplikuesve.
Rekomandimi B8	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme për shqyrtimin e kërkesave të lejeve ndërtimore në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 22,340,614€, derisa gjatë vitit është shpenzuar në vlerë 22,336,275€ apo 99.9%, Numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 2,467.

Çështja A6 - Mos-harmonizimi i kontratave të punës me legjislacionin në fuqi

Gjetja

Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, neni 102, paragrafi 1, parasheh se: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’u ofrojnë zyrtarëve aktualë për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës”, ndërsa paragrafi 2 përcakton se: “Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Pagat në sektorin publik”.

Nga testimi i mostrave për pagat e personelit, në 7 raste është identifikuar se kontratat e punës së nëpunësve të shëndetësisë nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin e saktë të pagës bazë (koeficientit). Megjithëse pagat e këtyre nëpunësve ishin përlogaritur në përputhje me Ligjin për Pagat, kjo nuk ishte shoqëruar me harmonizimin përkatës në kontratat e tyre të punës.

Sipas konfirmimit të pranuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së harmonizimit të kontratave, si rezultat i faktit se rregullorja përkatëse ende nuk ishte miratuar.

Ndikimi

Kjo gjendje paraqet mosrespektim të kërkesave ligjore në fuqi dhe krijon paqartësi, pasi kontratat e punës nuk pasqyrojnë nivelin e saktë të pagës bazë (koeficientit).

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e punës për nëpunësit e shëndetësisë të përditësohen dhe të harmonizohen në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B9 - Mos përgatitja e planeve të menaxhimit të kontratave dhe mangësi në menaxhimin e kontratave

Gjetja

Sipas nenit 70, pika 10, e Rregullorës 001/2022 për prokurimin publik, përcakton që, pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet do të përgatis dhe krijoj një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël.

Paragrafi 70,24.f. i Rregullores gjithashtu përcakton që, menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Derisa neni 70, pika 25 përcakton që, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për shqyrtimin, aprovimin dhe procedimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij/saj.

Gjithashtu, neni 54.15 sqaron se, kurdo që AK nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve/artikujve".

Rezultat e testimeve kanë identifikuar mangësi në menaxhimin e kontratave publike, kjo për shkak se:

- Në nëntë (9) raste, menaxherët e projekteve nuk kanë përgatitur planin për menaxhimin e kontratave, pavarësisht se pas nënshkrimit të kontratave janë caktuar zyrtarisht menaxherët dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë me përcaktim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
- Në 18 raste, menaxherët e projekteve dhe mbikëqyrësit e kontratave nuk kanë mbajtur dhe nuk kanë arkivuar përmes sistemit elektronik të e-Prokurimit dokumentacionin e menaxhimit të kontratave në proces realizimi, prej të cilave dhjetë (10) raste i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime dhe tetë (8) raste investimeve kapitale.
- Në projektin për mirëmbajtjen dhe rregullimin e rrjetit të ndriçimit publik në disa lokalitete, në vlerë 117,832€, menaxheri i kontratës, në situacionin e punimeve nuk kishte renditur pozicionet sipas formatit të paramasës dhe parallogarisë, për ti ndarë sipas përqindjes së secilit pozicion të punës, në mënyrë që të matej vlere të realizuar krahasuar me vlerën e planifikuar për pozicion. Ngjashëm, për furnizimin dhe ristrukturimin e rrjetit të ndriçimit publik në zonat I, II, III, IV dhe disa fshatra, në vlerë 50,000€, menaxheri i kontratës, në situacionin e punimeve nuk kishte renditur pozicionet sipas formatit të paramasës dhe parallogarisë, për ti ndarë sipas përqindjes së secilit pozicion të punës, në mënyrë që të matej vlere të realizuar krahasuar me vlerën e

planifikuar për pozicion.

Kjo kishte ndodhur për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm nga ana e menaxherëve të kontratave, dhe mos zbatimit të kërkesave rregullative për përgatitjen e planeve për menaxhim të kontratave.

Ndikimi

Mos përgatitja e planeve për menaxhimin e kontratave dhe mos përditësimi i informatave rreth implementimit të projekteve në modul elektronik pamundëson analizimin, përcjelljen dhe vlerësimin e performancës së realizimit të kontratave publike. Mos përgatitja e situacioneve të punimeve sipas formatit të paramasës vështirëson monitorimin dhe përcjelljen e realizimit të kontratës.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave përgatisin dhe nënshkruajnë së bashku me kontraktuesit planin e menaxhimit të kontratës, dhe se informatat rreth implementimit të projekteve azhurnohen me kohë në sistemin e-Prokurimi. Gjithashtu, menaxherët e kontratave të sigurojnë se situacionet e punëve të hartohen sipas formatit të paramasës dhe parallogarisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Në PVF të e vitit 2025, Komuna e Ferizajt ka shpalosur pasuritë kapitale në vlerë 250,213,186€, pasuritë jokapitale në vlerë 558,036€, dhe stoqe në vlerë 265,723€.

Çështja A7 - Nënvlërësim i regjistrit të pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja Rregullorja MF Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, paragrafi 3, përcakton që: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria".

Pasuritë e blera gjatë vitit 2025 si dhe bartjet e pronësisë nuk ishin regjistruar në regjistrat përkatës të pasurisë kapitale duke e nënvlerësuar vlerën e pasurisë kapitale në raportin vjetor financiar për 624,562€ dhe pasurisë jokapitale 107,838€. Në vijim, janë prezantuar detajet:

Në regjistrin e pasurisë së SIMFK-së nuk janë evidentuar disa pasuri të rëndësishme edhe pse pronësia e tyre, sipas marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Komunës së Ferizajt, ka kaluar te Komuna e Ferizajt si rezultat i investimeve të realizuara. Këto përfshijnë Sallën e Sporteve "Bill Clinton" në vlerë 483,683€, si dhe ndërtesën e Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve në vlerë 128,552€. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe pagesat për pajisje të tjera në vlerë 12,327€, të cilat nuk janë regjistruar si pasuri kapitale në regjistrin e SIMFK-së. Ndërsa sa i përket blerjeve të vitit për pasuritë jokapitale si pajisje tjera dhe mobilje në shumë totale prej 107,838€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-Pasuria.

Kjo situatë kishte ardhur si pasojë e mungesës së kontrolleve të brendshme gjatë procesit të regjistrimit të pasurisë, si dhe mos njoftimit me kohë të zyrtarit të pasurisë lidhur me këtë marrëveshje. Ndërkaq, mosregjistrimi i plotë i blerjeve vjetore në sistemin e e-Pasurisë kishte ndodhur për arsye se komuna kishte filluar funksionalizimin e këtij sistemi vetëm në fund të vitit, pa arritur të përfshijë në mënyrë të plotë të gjitha blerjet e realizuara gjatë atij viti.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive kapitale dhe jokapitale ndikon që vlera e pasurive të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive dhe komunikim mes drejtorive ashtu që pasuritë kapitale dhe jokapitale regjistrohen dhe raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mbajtja e pasurisë jo financiare kapitale si investim në vijim

Gjetja Rregullorja MF-nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në nenin 11 përcakton se pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim dhe nga momenti i aftësimit për përdorim, do të zbatohet zhvlerësimi.

Pasurit ë regjistruara në regjistrin kontabël të pasurive në klasën investime në vijim datojnë nga viti 2015, vlera e pasurive të regjistruara si investime në vijim me datën 31.12.2025 arrin në vlere 47,286,988€

Gjatë auditimit të regjistrave të pasurisë është identifikuar se projektet e mëposhtme, ndonëse kanë përfunduar dhe janë në shfrytëzim, vazhdojnë të figurojnë në regjistrat e pasurisë në SIMFK si investime në vijim:

- Ndërtimi i stacionit të ri të autobusëve në Ferizaj, në vlerë prej 1,019,906€;
- Ndërtimi i objektit II për nevojat e komunës në fshatin Gerlicë - Ferizaj, në vlerë prej 330,270€;
- Rikonstruimi i rrugës "Tahir Sinani" në Ferizaj, në vlerë prej 168,753€.

Si rezultat, këto pasuri nuk janë klasifikuar si pasuri të gatshme për përdorim dhe, rrjedhimisht, nuk është aplikuar zhvlerësimi përkatës.

Kjo ka ndodhur si pasojë e pensionimit të zyrtarit të pasurisë dhe mospërputhjeve në përshkrimet e pasurive/situacioneve në regjistra, ku asetet janë evidentuar me emërtime të ndryshme, duke vështirësuar riklasifikimin e tyre, pavarësisht vullnetit dhe gatishmërisë së zyrtarit të ri të pasurisë për t'i trajtuar si duhet.

Ndikimi

Mosklasifikimi i pasurisë kapitale si pasuri në përdorim ka ndikuar që zhvlerësimi të mos aplikohet dhe si pasojë kemi mbivlerësim të pasurive dhe rrjedhimisht edhe pasqyrim jo të saktë të pasurisë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të sigurojë që për projektet të cilat janë të përfunduara dhe janë në përdorim, të bëhen rregullimet e nevojshme në regjistrat e pasurisë ashtu që vlera e tyre në regjistra të pasqyrohet sipas klasave përkatëse të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Funksionalizimi jo i plotë i sistemit e-pasuria

Gjetja

Sipas nenit 6, pika 3, të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo-kapitale dhe stoku duhet të regjistrohen në sistemin e-Pasuria.

Edhe përkundër rekomandimeve të dhëna ndër vite, komuna gjatë vitit 2025 nuk kishte arritur ta funksionalizojë sistemin e-Pasuria në të gjitha njësitë dhe programet e saj.

Sistemi e-Pasuria ishte funksionalizuar vetëm në administratën komunale, ku përmes një komisioni të formuar është bërë regjistrimi i pasurisë në bazë të numërimit fizik. Ndërsa, sistemi nuk ishte funksionalizuar ende në shëndetësi dhe arsim.

Mos funksionalizimi i plotë i sistemit e-pasuria, ishte rezultat i përpjekjeve jo të mjaftueshme dhe mungesës së veprimeve të nevojshme dhe në kohë nga ana e komunës.

- Ndikimi** Mos përdorimi i sistemit e-pasuria rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit tyre.
- Rekomandimi C1** Kryetari duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e plotë të sistemit të e-pasurisë dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2025 në total janë 19,115,796€. Vlera e të arkëtueshmëve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë, taksat për lejet ndërtimore dhe nga qiraja nga shfrytëzimi i pronave publike dhe participimet në çerdhen publike.

Çështja B10 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 27 përcakton që “Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”.

Gjithashtu, në Vendimet për pagesë me këste për leje ndërtimore, pikat 6 dhe 7, përcaktojnë që nëse obligimet e parapara nuk përmbushen sipas afatit të përcaktuar me këtë vendim, do të ju anulohet vendimi për leje ndërtimore dhe objekti do të trajtohet si objekt pa leje ndërtimore.

Më tutje, sipas nenit 3 të Kontratës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, shfrytëzuesi obligohet që për shfrytëzimin e pronës afatshkurtër të paguaj shumën e cekur në kontratë deri më datën 05 të muajit rrjedhës.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2025 ishin gjithsej 19,115,796€, prej të cilave 14,593,388€ apo 76% ishin për tatimin në pronë. Komuna kishte dërguar letër rikujtim për detyrimet e papaguara ndaj disa debitorëve për përmbushjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë, megjithatë nuk kishte pasur asnjë rezultat në arkëtimin e këtyre borxheve, marrë parasysh rritjen e borxheve të tatimit në pronë krahasuar me vitin paraprak. Për më tepër në 36 raste të identifikuar komuna nuk kishte marrë masa shtesë, si ajo e veprimeve ligjore përmes përmbaruesit lidhur me mbledhjen e këtyre borxheve.

Po ashtu, në 16 raste të llogarive të arkëtueshme nga lejet ndërtimore në vlerë 2,407,097€⁹, cilat rrjedhin nga vendimet për pagesë me këste të lëshuara prej vitit 2020 e tutje, subjektet nuk i kishin përmbushur obligimet financiare sipas afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse. Megjithatë, komuna nuk kishte ndërmarrë veprimet e parapara në këto vendime, përkatësisht anulimin e lejeve ndërtimore apo iniciimin e procedurave përmbarimore. Vlen të theksohet se vetëm në katër (4) raste janë iniciuar procedura për përmbarim.

Gjithashtu, sa i përket qirave nga dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, në katër (4) raste me vlerë totale prej 166,523€, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore për mbledhjen e borxheve, edhe pse ishte tejkaluar afati i përcaktuar për pagesë sipas kontratave.

Mosndërmarrja e veprimeve sipas kushteve të përcaktuara në vendime rrit rrezikun e mosarkëtimit të të hyrave komunale dhe cenon zbatimin e dispozitave të përcaktuara në vendimet për leje ndërtimore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme,

përfshirë edhe ato ligjore, dhe hartimit të politikave nga ana e komunës për mbledhjen e të arkëtueshmeve.

Ndikimi

Mos arkëtimi me kohë i të arkëtueshmeve rezulton me të hyra buxhetore më të ulëta nga fondi i të hyrave vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga debitorët, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁰	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	46,013,005	49,736,489	49,685,073	42,966,383	45,328,253
Grante Qeveritare - Buxheti	38,038,699	39,459,382	39,433,118	36,148,784	35,744,461
Të bartura nga viti i kaluar	0	2,277,102	2,276,046	1,369,215	1,927,084
Të hyrat vetanake	7,974,306	7,974,306	7,971,534	5,402,089	7,612,849
Donacionet vendore	0	15,008	0	0	788
Donacionet e jashtme	0	10,690	4,374	46,296	43,070

Buxheti përfundimtar është më i lartët se buxheti fillestar për 3,723,484€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 1,420,684€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 2,277,102€, si dhe donacioneve në vlerë 25,698€.

Në vitin 2025 Komuna Ferizaj ka shpenzuar 99.9% të buxhetit përfundimtar ose 49,685,072€, pothuajse i njëjtë në krahasim me vitin paraprak, ku realizimi ishte 99.8%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	46,013,005	49,736,489	49,685,073	42,966,383	45,328,253
Pagat dhe mëditjet	20,913,354	22,340,614	22,336,275	20,758,916	20,572,860
Mallrat dhe shërbimet	10,001,123	10,957,077	10,944,856	7,997,874	9,322,932
Komunalitë	719,694	870,327	869,691	719,676	1,091,842
Subvencionet dhe transferet	2,050,000	2,794,000	2,793,162	1,761,211	1,525,404
Investimet Kapitale	12,328,834	12,774,470	12,741,090	11,728,706	12,815,214

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për paga dhe mëditje është rritur për 1,427,260€. Rritja është ndikuar nga vendimi i qeverisë për rritjen e koeficientit. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte 99.9%.
- Buxheti i mallrave dhe shërbimeve është rritur për 955,954€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar për 951,175€, dhe 4,779 € nga donacionet. Realizimi i buxhetit të kësaj kategori në fund të vitit ishte 99.9%.
- Buxheti final për shërbimet komunale është rritur për 150,633€. Kryesisht rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar për 150,000€ dhe 633€ nga donacionet. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte 99.9%.
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur nga të hyrat e bartura të vitit të kaluar për 744,000€. Realizimi i buxhetit të kësaj kategori në fund të vitit ishte 99.9%.
- Buxheti për investime kapitale është rritur për 445,636€. Rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në shumë 431,927€ dhe 13,709€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.74%. Programi i Investimeve Publike përfshin 109 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për investimet në infrastrukturën rrugore, nënkalimit, ndriçimit, salla sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, lumenjve, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2025 ishin 8,634,241€, derisa ishin planifikuar 7,974,306€, duke tejkaluar planin për 659,935€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga lejet ndërtimore, të hyrat nga tatimi në pronë, participimet, taksat për matjen e tokës, si dhe taksa tjera komunale. Në tejkalinin e planit të të hyrave të vitit 2025 kanë ndikuar të hyrat nga lejet ndërtimore, tatimi në pronë si dhe taksat tjera komunale.

Në vitin 2025 Komuna ka përfituar 1,727,283€ të hyra nga gjobat në trafik, 118,035€ nga gjobat e gjykatave, dhe 6,865€, nga Agjencioni i Pyjeve, apo në total 1,852,183€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	7,974,306	7,974,306	8,634,241	6,194,484	7,868,804
Të hyrat tatimore	2,946,970	2,946,970	2,371,732	2,142,214	3,618,562
Të hyrat jo tatimore	5,027,336	5,027,336	6,260,650	4,049,423	4,250,242
Të hyrat tjera	0	0	1,859	2,847	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Komunës së Ferizajit ka rezultuar me 13 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, raporti i auditimit të vitit 2024 ishte diskutuar në kuvendin komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, dy rekomandime janë zbatuar, dhjetë (10) nuk janë zbatuar ende, dhe një rekomandim është zbatuar pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit, dhe në rastet ku është e mundur të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim që pagesat të regjistrohen në përputhje me planin kontabël të thesarit	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e kontrolleve të duhura në azhurnimin me kohë të raportit të detyrimeve kontigjente, dhe se prezantimi i tyre në pasqyrat vjetore financiare të jetë i plotë dhe i drejtë.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës të financave analizojnë si duhet, mbajnë evidenca të sakta dhe të plota për detyrimet e papaguara, dhe se vlera e tyre të jetë e saktë në pasqyrat vjetore financiare.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në drejtoritë përkatëse në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë i tyre në pasqyrat vjetore financiare.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit nuk konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se pagesat për investimet kapitale bëhen nga fondi buxhetor i projektit përkatës. Në rastet e nevojshme dhe kur krijohen mundësit për ridestinim buxhetor, rialokimi i mjeteve të bëhet në pajtim me ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike përfundohen, pagesat përmbyllëse të kontratave të mos realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar i kualitetit të punimeve edhe për vlerën e aneks kontratave.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi

7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe të siguroj se detyrimet ndaj kontraktuesve paguhen brenda afateve kohore, duke shmangur në këtë mënyrë kostot shtesë për shkak të procedurave gjyqësore.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme për shqyrtimin e kërkesave të lejeve ndërtimore në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit të kërkesave për subvencionim u përmbahen kritereve të vendosura në thirrjen publike, duke përzgjedhur vetëm aplikuesit që përmbushin në tërësi kriteret e përcaktuara.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e kontratave në mënyrë që të sigurojë që kontratat publike realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve kontraktuale.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit nuk konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave përgatisin dhe nënshkruajnë së bashku me kontraktuesit planin e menaxhimit të kontratës, dhe se informatat rreth implementimit të projekteve azhurnohen me kohë në sistemin e-Prokurimi. Gjithashtu, menaxherët e kontratave të sigurojnë se situacionet e punëve të hartohen sipas formatit të paramasës dhe parallogarisë.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

12.	Pasuritë	Kryetarit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura nga zyrtari i pasurisë dhe zyrtari i depos me qëllim funksionalizimin dhe regjistrimin e tërë pasurisë jokapitale dhe stokut në sistemin e-pasuria.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se e-pasuria kishte filluar të përdoret vetëm për administratën komunale, duke qenë kështu jofunksionale në shëndetësi dhe arsim.	Pjesërisht i zbatuar
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga debitorët, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Komuna ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por gjatë auditimit konstatuam se ende përsëriten çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Arnisa Aliu, Udhëheqëse e ekipit




Fanol Hodolli, Anëtar i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi


REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Agim Aliu, Kryetar

Data: 16.06.2026,

Ferizaj



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹¹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹², duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Fatmir Neziri, Nuk ishte percaktu vlera; Mustafë Qerimi, Nuk ishte percaktu vlera; Ismet Halili, Nuk ishte percaktu vlera; Eurolindi HIB SH.P.K, Nuk ishte percaktu vlera; Ramadan Elezi, 146 470€; Athina Sylejmani, 7 043,61€.
- ⁶ Rregullimi i shëtitores rreth shtratit të lumit nga Ura e Dudit deri te Ura e Islamit në vlerë 74,131.64€; Ndërtimi i nënkalimit për vetura dhe këmbësor afër stacionit policor në vlerë 23,200.00€
- ⁷ Rikontruimi i rrugës Ferizaj-Pleshinë., 2 899 185€, Nuk ka plan për menaxhimin e kontrates Asfaltimi i rruges kryesore ne Zllatar dhe trotuari deri te shkolla (Aksi 1L=2915), 2 334 700€, Asfaltimi i rrugës Tërrn-Kosinë-Ferizaj., 2 442 542€, Rikonstruimi i rruges Bedri Asllani, 277 974€, Asfaltimi i rruges Fshati i vjetër-Komogllave-Ferizaj, 1 549 972€, Asfaltimi i rruges ne Rahovice dhe Talinoc te Muhaxhereve, 249 150€, Ritenderim Ndërtimi i Qendrës Multifunkionale në Ferizaj, 3 298 901€.
- ⁸ SIMFK- Pajisje tjera - Detektor - lexues për hyrje dalje në objek ne vlere 8,950euro dhe Pajisje tjera në vlerë 3,377euro ; E-Pasuria -Pajisje tjera, në vlerë 58,566€; Pajisje tjera, në vlerë 29,443€; Pajisje tjera, në vlerë 14,010€; Pajisje tjera, në vlerë 9,754€; Pajisje tjera, në vlerë 4,750€; Mobilje, në vlerë 3,630€; Mobilje, në vlerë 2,682€.
- ⁹ Flori Invest SHPK - 63,253.62; Premium Invest SHPK - 52,548.76; Isuf Sejdi Invest Brand SH.P.K - 251,840.70; Kom Residence SHPK - 237,805.84; NNP Intercon M SH.P.K - 217,044.80; Alwera Invest SH.P.K - 214,964.83; Avni Arifi - 171,976.35; Morea SH.P.K - 141,397.35; Macropus Group SH.P.K - 86,297.56; Argos Invest SH.P.K. - 85,401.64; Macropus Group SH.P.K - 86,500.00; Alwera Invest SH.P.K - 91,213.60;Plazza Holding 153.411,28 Kinemaja e Re-N SH.P.K 85.324,50 Riga-dt SHPK 71.584,00 Macropus Group SH.P.K 396.531,00
- ¹⁰ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹¹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹² Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.